



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.136/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj Hoti kryesuese, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e ankuesit [REDACTED], me vendbanim në Gjermani, të parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 10.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e parashtruar nga [REDACTED], ZL.Anr.136/2025, e datës 08.10.2025, me të cilën ka kërkuar përfshirjen në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 08.10.2025, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar ankesë ZL.Anr.136/2025, nga [REDACTED] nga Gjermania, në të cilën thekson se ka aplikuar si votues jashtë vendit, dhe se i është miratuar aplikimi, ndërsa në rastin kur ka kontaktuar me KQZ, që të pyet se pse nuk i ka ardhë dëftesa për votim, por për fat të keq thekson se ma kane refuzua, për arsye nuk e dije edhe nuk me kane thane se për çka me është refuzuar por unë dyshimin e kam se politikisht është.

Tutje në ankesë parashtruesi thekson se në ankesë i ka bashkangjitur dëshmitë me të cilat i është miratuar votimi jashtë vendit e tani thekson se i është refuzuar, kjo për mua është e papranuare sepse kjo është puro politike vetëm e vetëm ne të mos votojmë, sepse unë nëpërmjet këtij email

adrese i kam dërguar të gjitha të dhënat e tash gjoja se kjo mail adrese nuk është e vërtet. Parashtruesi i ankesës kërkon që PZAP, të anuloi vendimin e KQZ dhe të i jap të drejtën e votimit.

Në përgjigje në kërkesë KQZ-ja, ka theksuar se afati i ankesave ka përfunduar me datën 5 shtator 2025, ndërsa KQZ ka certifikuar listën votuese brenda dhe jashtë Kosovës me datën 6 shtator 2025.

Shtetasi [REDAKTUAR] (më tej parashtruesi i ankesës), me numër personal të Republikës së Kosovës 1170641139, ka aplikuar përmes platformës elektronike.

Duke u bazuar në Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës të miratuar nga KQZ, pika 2,7, është bërë verifikimi i votuesve të regjistruar. Andaj, është anuluar për shkak se pas tri tentimeve në ditë të ndryshme nuk është lajmëruar për verifikim, në telefonatat që janë bërë nga shërbimi votues në KQZ.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi, provave të cilat gjinden në shkresat e lëndës, dhe përgjigjes së dhënë nga KQZ, vëren se ankesa është e pabazuar.

Paneli e vlerësoj lejueshmërinë e ankesës dhe ka arritur në përfundim se e njëjta i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 98 paragrafi 3 të Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe në nenin 4 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimi dhe Vendosi së Ankesave.

Paneli, pasi shqyrtoi lëndën, provat e bashkangjitura dhe përgjigjes në ankesë vëren se ankesa është e pabazuar, për faktin se parashtruesi i ankesës gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas paragrafit 4, pika 1 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës të KQZ-së, në të cilin është përcaktuar se *“4. Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ bëhet si në vijim: 4.1. Plotëson të dhënat e adresës së banimit jashtë Kosovës: shtetin, kodin postar, qytetin, emrin e rrugës, numrin e banesës apo shtëpisë; 4.2. Plotëson email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal; 4.3. fotografon njërin prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shofer, duke mos përjashtuar dokumentet me afat të skaduar; 4.4. fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nën paragrafin 4.1...”*

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe përgjigjes së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës, [REDAKTUAR] ka aplikuar përmes platformës elektronike, dhe duke u bazuar në Procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës të miratuar nga KQZ, pika 2,7, është bërë verifikimi i votuesve të regjistruar, dhe për shkak se pas tri tentimeve në ditë të ndryshme nuk është lajmëruar për verifikim, në telefonatat që janë bërë nga shërbimi votues në KQZ.

Në këto rrethana, Paneli vlerësoi se parashtuesi i ankesës nuk ka plotësuar njërin nga kriteret thelbësore të përcaktuara në kuadër të procesit të regjistrimit për votim jashtë vendit, konkretisht kriterin që lidhet me plotësimin e email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal kriter ky i përcaktuar shprehimisht me nenin 3 paragrafin 4, pika 2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, të nxjerrë nga KQZ.


Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me neni 3 paragrafi 4 pika 4.2, e lidhur me paragrafi 5 pika 5.3 e Rregullores të sipërcituar, dhe në bazë të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.136/2025, datë 10.10.2025

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshillë Juridike: kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.91/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.Sc.Muhamet Rexha kryetar, Milena Gjeriq dhe Nenad Laziq, anëtarë, në çështjen juridike të parashtruesit të ankesës Enver Shaqiri, me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, me seli në Prishtinë, për shkak të mos përfshirjes në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më 12 Tetor 2025, tani duke vendosur sipas ankesës Enver Shaqirit, paraqitur kundër Vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ZL.A.nr.136/2025 dt.10.10.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më 14.10.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa themeltë ankesa e Enver Shaqirit, me vendbanim në Gjermani, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ZL.A.nr.136/2025 dt. 10.10.2025.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) ZL.A.nr.136/2025 të dt.10.10.2025, është refuzuar e pa bazuar ankesa ZL.A nr.136/2025 dt.8.10.2025, e ushtruar nga Enver Shaqiri, me vendbanim në Gjermani, me të cilën ka kërkuar përfshirjen në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më dt.12 Tetor 2025.



Kundër vendimit të sipërpërmendur të PZAP-së, Enver Shaqiri, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, me të cilën konteston ligjshmërinë e vendimit të PZAP-it, përkatësisht, shkeljes së të drejtës themelore për zgjedhje të lira, për shkak të mos përfshirjes në Listën përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendi, me propozim (të pa specifikuar), që të shqyrtohet dhe aprovohet ankesa e tij.


Përgjigje në ankesë ka paraqitur PZAP-i, nëpërmjet të cilës kundërshton pretendimet ankimore dhe propozon që ankesa të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerësoj ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të pretendimeve ankimore dhe të përgjigjes në ankesë si dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i, më datën 8.10.2025, përmes emailit zyrtar ka pranuar ankesë, me numër si më lartë, nga Enver Shaqiri, Gjermani, në të cilën thekson se ka aplikuar si votues jashtë vendit, dhe se i është miratuar aplikimi, ndërsa, në rastin kur ka kontaktuar me KQZ, që të pyet se pse nuk i ka ardhur dëftesa për votim, por për fat të keq, thekson se i është refuzuar, për arsyet që nuk i din dhe ka shtuar se përmes emailit ka dërguar të gjitha të dhënat, ka propozuar që të anulohet vendimi i KQZ dhe të i jap të drejtën e votimit. Në përgjigje në kërkesë KQZ-ja ka theksuar se afati i ankesave ka përfunduar më dt.5.09.2025, ndërsa, KQZ ka certifikuar listën votuese brenda dhe jashtë vendit më dt.6.09.2025. Shtetasi Enver Shaqiri, me nr.pers. të Republikës së Kosovës 1170641139, ka aplikuar përmes platformës elektronike. Duke u bazuar në Procedurat Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës të miratuar nga KQZ, pika 2.7, është bërë verifikimi i votuesve të regjistruar. Andaj, është anuluar sepse për shkak se pas tri tentimeve në ditë të ndryshme nuk është lajmëruar për verifikim, në telefonatat që janë bërë nga shërbimi votues i KQZ.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, ka shqyrtuar shkresat e lëndës dhe vendimin përkatës të KQZ-së, konstatoi se i njëjti është i drejtë dhe i ligjshëm dhe bazuar në këtë vlerësoi se ankesa është e pa bazuar, pasi që parashtresuesi i saj, gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas par.4, pika 1 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës të KQZ-së, në të cilin është përcaktuar se “ 4. Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ-së, bëhet si në vijim: 4.1 Plotëson të dhënat e adresës së banimit jashtë Kosovës: shtetin, kodin postar, qytetin, emrin e rrugës, numrin e banesës apo shtëpisë; 4.2. Plotëson email adresën personale dhe numrin



e telefonit mobil personal; 4.3. fotografon njërin prej dokumenteve identifikuese të lëshuara nga Republika e Kosovës, si letërnjoftim, pasaportë ose patentë shofer, duke mos përjashtuar dokumentet me afat të skaduar; 4.4 Fotografon dokumentin që dëshmon adresën e votuesit jashtë Kosovës, sikurse në nënp.4.1 ..”. Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe përgjigjes së KQZ, Paneli vlerëson se parashtuesi i ankesës, Enver Shaqiri ka aplikuar përmes platformës elektronike dhe duke u bazuar në procedurën Standarde të Veprimit për Regjistrimin e Votuesve Jashtë Kosovës të miratuar nga KQY-ja, pika 2.7, është bërë verifikimi i votuesve të regjistruar dhe për shkak se pas tri tentimeve në ditë të ndryshme nuk është lajmëruar për verifikim, në telefonatat që janë bërë nga shërbimi votues i KQZ-së. Në këto rrethana Paneli vlerësoi se parashtuesi i ankesës nuk ka plotësuar njërin nga kriteret thelbësore të përcaktuara në kuadër të procesit të regjistrimit për votim jashtë vendit, konkretisht kriterin që lidhet me plotësimin e email adresës personale dhe numrin e telefonit mobil personal kriter ky i përcaktuar shprehimisht me nën paragrafin 4,pika 2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025 Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, të nxjerrë nga KQZ-ja, ndaj, nga arsyet e sipër theksuara dhe duke u bazuar në nenin 17 par.3, 118 par.1, nenin 119 par.3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 3, par.4, pika 4.2 të nenit 3 të Rregullores të sipër cituar dhe në bazë të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli ka vendosur si në dispozitiv të vendimit të tij.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga kjo gjendje e çështjes, i pranon si të themelta konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të PZAP-it, që ka marrë sipas vendimit të ankimuar lidhur me refuzimin e ankesës si të pa bazuar, përkitazi me mos përfshirjen në Listën Përfundimtare të Votuesve Jashtë Vendit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, që do të mbahen më dt.12 Tetor 2025, me që vlerëson se vendimi i këtij organi nuk është i kundërligjshëm dhe nuk është në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe as me Rregulloret a legjislacionin sekondar të KQZ dhe PZAP-it.

Objekt shqyrtimi dhe vlerësimi në Gjykatën Supreme të Kosovës ishin thëniet e parashtuesit të ankesës përkitazi me shkeljet e pretenduara, mirëpo, në rastin konkret, këto pretendime u refuzuan si të pabazuara edhe nga kjo Gjykatë, sepse të njëjtat nuk janë provuar dhe faktuar, si dhe nuk kanë mbështetje ligjore, ndaj, si të tilla juridikisht, janë të paqëndrueshme. Kështu, për faktin sepse, sikundër u theksua edhe më lartë, PZAP me të drejtë ka arritur në përfundimin se parashtuesi i ankesës, gjatë aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës, përmes platformës elektronike të KQZ-së, ka bashkangjitur dokumentet e kërkuara, të specifikuara si më lartë, mirëpo, nga verifikimi i këtyre dëshmive Paneli, veç tjerash, vëren se parashtuesi i



ankesës nuk ka plotësuar kriteret e sipër cekura, të email adresës personale dhe numrin e telefonit mobil personal, pra, rezulton qartë se parashtruesi i ankesës nuk ka plotësuar njërin nga kriteret thelbësore të përcaktuara në kuadër të procesit të regjistrimit për votim jashtë vendit, konkretisht kriterin që lidhet me dëshminë e adresës së banimit të aplikuesit, kriter ky i përcaktuar shprehimisht me dispozitat e lartë cituara.

Prandaj, nga këtu, kjo Gjykatë, konsideron se në rastin konkret juridik, është marrë vendim i drejtë, me të cilin nuk është bërë diskriminim dhe lidhur me rastin konkret nuk është cenuar e drejta zgjedhore dhe ndonjë e drejtë themelore e paraparë me Ligj dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, nuk janë shkelur parimet themelore të procesit zgjedhor të parapara shprehimisht me dispozitat e nenit 4 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe me dispozitat përkatëse të Konventës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Nga këtu, ankuesi, me pretendimet ankimore, nuk ka arritur që të vë në dyshim vendimin e ankimuar të PZAP-it, i cili, për arsyt e sipër cekura, është i drejtë dhe i ligjshëm, andaj, kjo Gjykatë, ankesën e parashtruar nga paraqitësi i sipër përmendur, kundër vendimit të kontestuar e refuzoi si të pa themeltë.

Nga arsyet e sipër përmendura , e në pajtim me dispozitën e nenit 118 pika 4 të Ligjit Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GYJKATA SUPREME E KOSOVËS- PRISHTINË

AA.nr.91/2025 dt.14.10.2025



Kryetar i kolegjit,

Mr.Sc.Muhamet Rexha
Republika Kosovo

SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE

Punëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

OSOVËS



Sheji i shkresës: AA-91/2025
Oznaka spisa: 16.10.2025

PËR DORËZIM PERSONAL DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

Entimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në
në dorëzimi i sa pas lënjes së lajmërimit
dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në
punës së tij, dorëzimi është bërë:
marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqjuit,
o n'atë vend me marrësin.

om pokusajo dostave nije zatecen na mestu
ni posle ostavljenog pismenog obavestenja
edjeno vrene u svom stanu radnom mestu,
lanu domacin. Primaoca nastojniku zgrace
a istom radnom mestu primaocem

ri i familjes së tij e refuzon marrjen e
së në vendin e punës së marrësit (duke e
të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

m njenog domacinstva odbio prijem, pismo
m mestu primaoca (pribieno na vratima
nilac zaposlen)

_____ në ora _____
u _____ cas.

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

1-Aktgigjykurje
14.10.2025

Numri i shtojcave: _____
broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartëpërmendur
më (me fjalë)
Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovima)

KSH. 17.10.2025

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Potpis primioča ili lica koje je
pismeno primilo u zamenu)

M.47

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljača

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë
dorëzuesi, duke shënuar shkaktun pse marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet.
Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač,
napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.